



DEGA NË LIPJAN – OGRANAK U LIPLJANU

P.nr.713/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të akuzuarit I. B. nga fsh. J. K. L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.3334/16 të dt.26.10.2016, për shkak të veprës penale, Vjedhje e pyllit nga neni 358 par 2 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me dt.09.03.2017, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit Shemsije Asllani, dhe të akuzuarit, në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

I. B., nga i ati M., i lindur me dt. *data e lindjes...*, në V., me vendbanim në fsh. J. K. L., shqiptarë, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet ne liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Më dt. 07.06.2016, rreth orës 15:40, me qëllim të vjedhjes në pyll, me të cilin qeverisë Regjioni Ekonomiko-Pyjor i Akllapit, në vendin e quajtur “Llali i Vogël-Mulliri”, i pandehuri ka prerë 110 copë, dru të llojit shkozë, me diametër 12-14 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 2.20 m³ me ç’rast të dëmtuarës Autoriteti Pyjor Komunal, i ka shkaktuar në vlerë prej 336-€ (euro).

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 21, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 73, 358 par. 2 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së të pandehurin e gjykon me,

DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 tre) muajve, dhe me dënim me gjobë në shumë prej 250-€, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari në afat prej 1(një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

DETYROHET i akuzuari që të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës, t’ia paguaj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 336.00-€ (euro), në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

DETYROHET i akuzuari që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumën prej 20 euro, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.3334/16 të dt.26.10.2016, e ka akuzuar të pandehurin I. B. nga J., për shkak të veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par 2 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar, ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues, dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili është bërë konform dispozitave ligjore dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe nga gjykata ka kërkuar që me rastin e matjes së dënimit, të njëjtit ti shqiptohet një dënim sa më i butë, ngase i njëjti është i pa punë dhe i vetmi mbajtës i familjes, dhe njëherit kësaj gjykate i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëritë vepra të tilla të ngjashme.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të pandehurit, për veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par 2 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se i pandehuri është i vetmi mbajtës i familjes dhe i pa punë, sjelljen e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla të ngjashme, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2, pika 2.6 të KPPK-së.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.

P.nr. 713/16 dt. 09.03.2017

**Sekretarja juridike
Nexhmije Ahmeti**

**GJYQTARI
Avdirrahman Gashi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.